




KUVENDI

Nr. 8, 2017



- KUVENDI I SHQIPËRISË
ÇELI PUNIMET E LEGJISLATURËS SË 9-të
- NDIKIMI I REFORMËS NË DREJTËSI
MBI PARIMIN E AKSESIT NË GJYKATË
- LIDERSHIPI NË SHOQËRINË
LIBERALDEMOKRATE
- BALLKANI NË SISTEMIN E VLERAVE
EUROPIANE DHE BOTËRORE
- ICH BIN EIN BERLINER



Përmbajtja

Nr. 8, 2017

■ NË VEND TË EDITORIALIT	3	■ Lidershipi në shoqërinë liberaldemokrate	57
		<i>Nga Melina KABO</i>	
■ NJË VËSHTRIM MBI LEGJISLATURËN E 9-të		■ Qeveria dhe ndikimi në bizneset e vogla	
■ Kuvendi i Shqipërisë		e të mesme	63
çeli punimet e Legjislaturës së 9-të	4	<i>Nga Sorina KOTI</i>	
■ Zoti Gramoz Ruçi zgjidhet Kryetar		■ 1997-a, pas 20 vjetësh	
i Kuvendit të Shqipërisë	8	çfarë mund të shohim ndryshe?	70
■ Konfigurohet Kuvendi i Shqipërisë	11	<i>Nga Përparim KABO</i>	
■ Kuvendi miraton programin politik		■ Ballkani në sistemin e vlerave europiane	
dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave	13	dhe botërore	76
		<i>Nga Bashkim RAMA</i>	
		■ AKTIVITETE	
■ JETË PARLAMENTARE		■ Mbahet Konferenca e 8-të	
■ Kuvendi përshëndet nismën		e kryetarëve të parlamenteve	
për krijimin e Parlamentit Rural Shqiptar	20	të vendeve të Ballkanit Perëndimor	83
■ Veprimtaria e Kuvendit		■ Shqipëri-Kosovë,	
gjatë Legjislaturës VIII	24	forcim i bashkëpunimit	
■ Përmbledhje e përparimit të reformës		mes dy vendeve	84
në sistemin e drejtësisë	35	■ Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë,	
		zoti Gramoz Ruçi,	
		vizitë zyrtare në SHBA	88
		■ FJALIME QË JEHOJNË	
■ STUDIME BASHKËKOHORE		■ Ich bin ein Berliner	90
■ Ndikimi i reformës në drejtësi		Xhon Fitzxherald KENEDI	
mbi parimin e aksesit në gjykatë	42		
<i>Nga Ejona XHEMALAJ</i>			
■ Reforma në drejtësi			
dhe edukimi ligjor i publikut	48		
<i>Nga Nevila NIKAJ</i>			
■ Kultura e ligjërimit konfliktual	52		
<i>Nga Roland LAMI</i>			
		■ NJË DRITARE NË PARLAMENTET ETJERA	93

Bordi i revistës:

Prof. dr. Aurela ANASTASI
Prof. dr. Fatos TARIFA
Prof. dr. Artan HOXHA
Prof. dr. Vilson KURI
Prof. dr. Roland ZISI

Prof. dr. Sulo HADËRI
Prof. asoc. dr. Afrim KRASNIQI
Prof. asoc. dr. Përparim KABO
Prof. asoc. dr. Roland LAMI
Dr. Saemira GJIPALI
Dr. Sorina KOTI

Me synimin që revista të shërbejë si një platformë gjithëpërfshirëse, në të do të zënë vend shkrime në të cilat ballafaqohen ide e alternativa të ndryshme. Publikimi i tyre nuk shpreh qëndrimin, pikëpamjet apo politikat e Kuvendit të Shqipërisë.

Revista "Kuvendi"
përgatitet
nga Shërbimi i Botimeve Parlamentare
të Kuvendit të Shqipërisë

Ndikimi i reformës në drejtësi mbi parimin e aksesit në gjykatë


“Në kuadër të zhvillimeve aktuale në Shqipëri në aspektin ekonomik dhe shoqëror, si dhe problematikave të shfaqura brenda sistemit të drejtësisë, u pa e nevojshme ndërmarrja e reformës imediate dhe konkrete në këtë sistem. E drejta për të pasur akses në gjykatë, e konsideruar si hallka e parë lidhëse mes individit dhe sistemit gjyqësor, është cenuar në vijimësi dhe nuk është siguruar proporcionalisht. Aksesit në gjykatë konsiderohet si një ndër të drejtat themelore të individit lidhur me një proces të rregullt ligjor, e drejtë që sanksionohet në çdo akt themelor kombëtar e ndërkombëtar. Kjo e drejtë i sigurohet çdo individit dhe shteti ka si detyrim që ta garantojë atë duke shfrytëzuar çdo mekanizëm të nevojshëm. Reforma në drejtësi pasqyron në mënyrë të detajuar objektivat dhe ndërhyrjet që duhet të ndërmerren për rritjen e aksesit dhe efektivitetit në sistemin gjyqësor. Punimi do të përqendrohet në trajtimin e parimit të aksesit në gjykatë, si një gur themeli në ngritjen e një sistemi ligjor të mirorganizuar dhe efektiv, masat që ndërmerr reforma në këtë drejtim dhe një analizë e pasojave lidhur me zbatimin e strategjisë dhe të planit të veprimit në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.”

Gjyrimi i çështjeve përmban rregulla themelore në bazë dhe për zbatim të të cilave realizohen të gjithë hapat proceduralë të procesit. Këto rregulla përbëjnë parimet themelore që rregullojnë të drejtën procedurale. Një ndër parimet më të rëndësishme për gjykimin është zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor, që parashikohet në çdo akt kombëtar e ndërkombëtar.

Në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, në hallkën e parë lidhëse mes individit dhe gjykatës vepron parimi i aksesit në gjykatë, i konsideruar si një e drejtë që duhet t'i garantohet çdo individit. Kuadri ligjor parashikon se për mbrojtjen e një të drejte të mohuar apo të cenuar, apo për kundërshtimin e një akuze çdo individ gëzon të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Praktika gjyqësore shqiptare

dhe europiane ka treguar se për garantimin efektiv të aksesit në gjykatë para së gjithash kërkohet ndërmarrja e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Për shkak të rëndësisë që ka zbatimimi i këtij parimi në praktikë, shteti ka si detyrim që ta garantojë atë duke shfrytëzuar çdo mekanizëm të nevojshëm. Një mekanizëm i tillë gjithëpërfshirës konsiderohet reforma në drejtësi.

Zhvillimet në shoqëri në aspektin ekonomik dhe shoqëror si dhe problematikave të shfaqura brenda sistemit të drejtësisë në Shqipëri kanë sjellë si prioritet themelor nevojën për përshtatjen e legjislacionit të institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë me legjislacionet europiane. Në kuadër të problematikave dhe nevojës për ndërhyrje, është reforma në drejtësi ajo që tashmë pritet të veprojë për të bërë një riorganizim



Msc. Ejona XHEMALAJ,
pedagoge në Universitetin
Mesdhetar të Shqipërisë

të gjykatave në përputhje me standardet europiane, me objektiv parësor rritjen e aksesit dhe të efektivitetit në gjykatë.

Parimi i aksesit në gjykatë, praktika shqiptare dhe ajo europiane

Në nenin 42, pika 2 të Kushtetutit parashikohet se “për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të individit dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij” ka të drejtë dhe publik brenda një afati arsyesor nga një gjykatë e parare dhe e paanshme e caktuar me ligj”. Parashikim ky që shprehet edhe në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku shprehimisht thuhet: “Çdo person ka të drejtë që të



«Tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe lirshëm një afati të arsyeshëm nga një gjykatë pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu dhe për bazueshmërinë e akuzave penale në ngarkim të tij.»

Në vendimet e saj Gjykata Kushtetuese është shprehur se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cënuesura të drejtën që t'i drejtohen një gjykatë, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur nga ana e gjykatës një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë

substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht themelor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës¹.

Gjykata vlerëson se në një shoqëri demokratike e drejta për administrim të mirë të drejtësisë zë një vend të dallueshëm dhe asnjë interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes².

Nga ana procedurale e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk varet dhe nuk kufizohet nga ndonjë afat kohor.

Ajo mund të kërkohet në çdo kohë dhe gjykata është e detyruar me ligj të marrë në shqyrtim këtë kërkesë, pavarësisht nga koha që ka kaluar nga shkelja e të drejtave që pretendohen³. Koha kur subjektit të së drejtës nuk i sigurohet më kjo ndihmë përkon me mbarimin e afatit të parashkrimit, domethënë kur ky subjekt nuk ka më mundësi që ta realizojë këtë të drejtë. Kjo do të thotë se parashkrimi në një çështje civile nuk mund të shuajë të drejtën e padisë në kuptimin procedural, pra të drejtën për të paraqitur padi para gjykatës apo organeve kompetente. Ai shuan vetëm të drejtën për të përfituar mbrojtjen e organeve, shuan vetëm mundësinë për të realizuar në mënyrë të detyrueshme

¹. Vendim nr. 8, datë 26.02.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

². Vendim nr. 42, datë 29.09.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

³. Julana Latiqi, "E drejta civile, f. 148, Tiranë.

të drejtën e shkelur. Ligjvënësi ka vendosur afate parashkrimi për padi dhe vepra penale të caktuara jo me synim kufizimin e së drejtës për të pasur akses në gjykatë, por me synim dhënien e sigurisë juridike për kërkimin e një të drejte të shkelur apo për kundërshtimin e një akuze penale.

Gjykata Europiane e të Drejtave

të së drejtës së tij për korrespondencë në bazë të nenit 8 dhe së drejtës së tij për akses në gjykatë sipas nenit 6 (1).

Në çështjen “Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar”⁵ të burgosurve të akuzuar për shkelje disiplinore iu mohua kërkesa për t’u konsultuar me një avokat. Edhe pse ata e kishin përfituar të drejtën për

nuk plotëson standardet e parashikuara në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Reforma në drejtësi lidhur me parimin e aksesit në gjykatë

Mungesa e pavarësisë, efikasitetit, besueshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë sollën nevojën e reformës në drejtësi. Kjo reformë parashikon ndryshime në Kushtetutë, ndërhyrje në Gjykatën Kushtetuese, në pushtetin gjyqësor në tërësi, në drejtësinë penale, shërbimin ligjor, profesionet e lira dhe pothuajse në çdo hallkë të sistemit të drejtësisë.

Në dokumentin “*Analiza e sistemit të drejtësisë në Shqipëri*” u bë një analizë e plotë e gjendjes aktuale të sistemit, duke pasqyruar problematikat dhe nevojat për ndërhyrje me qëllim përmirësimin e situatës. Në vijim të këtij dokumenti një grup ekspertësh të nivelit të lartë hartuan “*Strategjinë e reformës në sistemin e drejtësisë*” dhe “*Planin e veprimit*”, dokumente që shërbyen si një bazë e mirë për hartimin e kuadrit të ri ligjor.

Si një ndër parimet më themelore të procesit gjyqësor, aksesit në gjykatë është vendosur në krye të parimeve në ligjin e ri “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Neni 5 i këtij ligji parashikon: “*Çdo person trajtohet në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë diskriminim nga gjykatat.*” Më tej vijon: “*Çdo person ka akses të barabartë në gjykatë, si dhe ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij ligjore sipë parashikohet me ligj. Seanca gjyqësore është publike, përveç rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe. Gjykatat funksionojnë në mënyrë transparente, të shpejtë dhe efikase*”⁶.

Lidhur me pushtetin gjyqësor reforma parashikon si objektiv parësor rritjen e aksesit dhe të efektivitetit nëpërmjet riorganizimit të gjykatave në përputhje me standardet europiane. Riorganizimi i gjykatave nënkupton një shpërndarje të tyre në përputhje me ndarjen e re territoriale,

Praktika gjyqësore shqiptare dhe europiane ka treguar se për garantimin efektiv të aksesit në gjykatë para së gjithash kërkohet ndërmarrja e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Për shkak të rëndësisë që ka zbatimi i këtij parimi në praktikë, shteti ka si detyrim që ta garantojë atë duke shfrytëzuar çdo mekanizëm të nevojshëm. Një mekanizëm i tillë gjithëpërfshirës konsiderohet reforma në drejtësi.

të Njeriut ka shqyrtuar disa raste në të cilat cenohej parimi i aksesit në gjykatë. Duke u konsideruar si një parim themelor për individin, gjykata nuk duhet të kufizojnë ose të ndalojë shqyrtimin gjyqësor për çështje të caktuara ose për kategori të caktuara individësh. Shumë raste nga praktika gjyqësore lidhur me shkeljen e këtij parimi janë sjellë nga të burgosurit. Në çështjen “Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar”⁴ një i burgosur dëshironte të paraqiste një padi civile për shpifje kundër një roje burgu, pasi e kishte akuzuar në mënyrë të rreme për nxitjen e një proteste në ambientet e shlyerjes së dënimit. Por letrat e tij, të paraqitura te një avokat dhe në Komisionin Europian për të Drejtat e Njeriut, ishin censuruar dhe ishin mbajtur në burim nga autoritetet e burgut. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi shkelje

akses në gjykatë, konsultimet me avokatin lejoheshin vetëm në prani të një oficeri burgu. Me konstatimin e një shkelje të nenit 6 (1) të Konventës, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh se mungesa e kontaktit mes avokatit dhe klientit përbën një ndërhyrje në të drejtën e aksesit në gjykatë.

Komisioni Europian dhe Gjykata kanë ngulmuar në garantimin e zbatimit të këtij parimi për të siguruar në tërësi një proces të rregullt ligjor. Vlen të theksohet se Gjykata e Strasburgut ka shqyrtuar kryesisht rastet gjyqësore në kontekstin e procesit gjyqësor civil, në të cilin e drejta për akses ushtrohet në mënyrë aktive nga individit. Por aksesit në gjykatë, si parim, është po aq i rëndësishëm për mbarëvajtjen e çështjeve penale në ofrimin e mbrojtjes kundër caktimit të një akuze penale nga një organ që

numrin e popullsisë dhe ngarkesën me çështje gjyqësore. Marrja e një masë të tillë mundëson një akses më të shpejtë dhe efektiv në gjykatën kompetente për çdo subjekt kërkues të një të drejte të shkelur, të mohuar ose për kundërshtimin e një akuze. Lidhur me këtë objektiv është studiuar legjislacioni përkatës dhe tashmë kërkohet realizimi i një qasjeje të plotë me ndarjen e re territoriale-administrative, si dhe përcaktimi i një harte të plotë për gjykatat, me qëllim shtrirjen kapilare të shërbimit gjyqësor në të gjithë territorin e banuar të Republikës së Shqipërisë.

Një nga problematikat kryesore që hasin subjektet kërkuese të të drejtave ka të bëjë me tejzgjatjen e procedurave në gjykatë, pra e drejta për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, çka përbën një nga parimet bazë të procesit të rregullt ligjor. Kjo e drejtë, edhe pse gjendet e sanksionuar në çdo akt kombëtar e ndërkombëtar, në Shqipëri nuk gjen zbatim në mënyrë efektive. Reforma parashikon një përcaktim më të qartë të juridiksionit të të gjitha llojeve të gjykatave për të evituar konfliktin e kompetencës, mbingarkesën e disa gjykatave dhe tejzgjatjen e gjykimit. Duhet të rishikohen kufijtë e kompetencës shqyrtuese të Gjykatës së Lartë, të gjykatave të apelit dhe organizmi i tyre për të shmangur zvarritjen e paarsyeshme të proceseve gjyqësore. Me synim forcimin e rolit dhe të funksionimit të gjykatave të shkallës së parë, shihet gjithashtu si mundësi riorganizimi i këtyre gjykatave në dy nivele: a) gjykatë rrethi (ose gjykatë paqeje) për gjykimin e padive për çështje vogla, të padive pa palë kundërshtare dhe çështjeve të thjeshta administrative etj.; dhe b) gjykatë qarku, të cilat gjykojnë të gjitha çështjet e tjera dhe ankimet ndaj vendimeve të gjykatave të rrethit.

Një hap tjetër në ndihmë të subjektit për të pasur një akses efektiv në gjykatë është zgjerimi i kompetencës lëndore të gjyqtarit lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve.

Gjykata e Lartë është gjykata e

instancës së fundit në sistemin gjyqësor (penal, civil dhe administrativ). Në bazë të Kushtetutës, Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, Gjykata e Lartë kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat më të ulëta. Gjithashtu Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose të ndryshojë praktikën gjyqësore⁷.

Reforma në drejtësi parashikon ndryshime të mëdha në Gjykatën e Lartë. Diskutohet mundësia e kalimit të Gjykatës së Lartë si pjesë integrale e sistemit gjyqësor dhe rrjedhimisht shtrirjen e kompetencave të

e juridiksionit të GJL-së për të rishikuar vendimet e gjykatave më të ulëta vetëm për shkaqe të rëndësishme të ligjit; 3) forcimin e kompetencave të GJL-së për kontrollin e respektimit të parimeve të gjykimit të drejtë; 4) dhënien e kompetencës për të gjykuar mosmarrëveshjet mes gjykatave etj. Gjithashtu parashikohet rishikimi i dispozitave kushtetuese, duke synuar heqjen e juridiksionit fillestar të GJL-së në funksion të garantimit të barazisë së shtetasve para ligjit, garantimit të së drejtës për një ankim efektiv dhe rritjes së eficiencës në luftën kundër korrupsionit.

Në kuadër të garantimit të transparencës së pushtetit gjyqësor dhe

“ Lidhur me pushtetin gjyqësor reforma parashikon si objektiv parësor rritjen e aksesit dhe të efektivitetit nëpërmjet riorganizimit të gjykatave në përputhje me standardet europiane. Riorganizimi i gjykatave nënkupton një shpërndarje të tyre në përputhje me ndarjen e re territoriale, numrin e popullsisë dhe ngarkesën me çështje gjyqësore. Marrja e një masë të tillë mundëson një akses më të shpejtë dhe efektiv në gjykatën kompetente për çdo subjekt kërkues të një të drejte të shkelur, të mohuar ose për kundërshtimin e një akuze. ”

KLD-së mbi të.

Reforma parashikon një rishikim dhe qartësim të juridiksionit të Gjykatës së Lartë për të forcuar profilin e saj si një gjykatë ligji përmes ndërhyrjeve kushtetuese dhe ligjore, të cilat do të synojnë: 1) forcimin e kompetencave të GJL-së për zbatimin e unifikuar të ligjit; 2) kufizimin

⁴ Aplikimi nr. 4451/70, vendimi i datës 21 shkurt 1975.

⁵ Aplikimi nr. 8342/95, vendimi i datës 28 qershor 1984.

⁶ Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 5.

⁷ “Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë”.

të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në përputhje me standardet europiane, reforma parashikon eliminimin e problemeve që lidhen me tarifat gjyqësore dhe që pengojnë aksesin e qytetarëve në sistemin gjyqësor, si dhe pajisjen me burimet e nevojshme njerëzore, financiare dhe infrastrukturale të institucionit shtetëror që duhet të ofrojë për individët dhe grupet në nevojë ndihmë ligjore falas. Rregullimi ligjor i kësaj çështjeje pasqyrohet në projektligjin "Për tarifat dhe shpenzimet gjyqësore në Republikën e Shqipërisë".

Efektet e reformës në drejtësi mbi parimin e aksesit në gjykatë

Dokumenti "Analiza e sistemit të drejtësisë" ka përcaktuar rregulla dhe procedura të reja për zhvillimin e procesit gjyqësor. Kuadri ligjor shqiptar ka një tërësi mjetesh ankimi, të parashikuara jo vetëm në dispozitat kushtetuese, por edhe në ligjet organike (në Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurave Administrative). Mjetet ligjore që përdoren për të kundërshtuar një vendim civil, administrativ ose penal janë: ankimi në Gjykatën e Apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim⁸. Këto mjete ligjore i sigurojnë aksesin individit në gjykatat e shkallëve më të larta për të kundërshtuar një vendim të një shkalle më të ulët.

Në ndryshimet lidhur me pushtetin gjyqësor është parashikuar që Gjykata e Lartë të rishikojë vendimet e gjykatave më të ulëta vetëm për shkaqe të rëndësishme të ligjit. Sipas parashikimit ligjor, rastet kur subjekti mund të paraqitet për rekurs në Gjykatën e Lartë janë: kur ligji është zbatuar keq; ka shkelje të rënda të rregullave procedurale (neni 467/a KPRC); ka shkelje të tjera procedurale, të cilat kanë penguar një hetim të plotë të çështjes; kur vendimi i Gjykatës së Apelit bazohet në një fakt thelbësor që është në kundërshtim me

vendimet e gjykatës së shkallës së parë⁹. Ndryshimet ligjore lidhen kryesisht me pikësynimin për angazhimin e Gjykatës së Lartë vetëm me unifikimin e praktikës gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 42, datë 29.09.2011 është shprehur se "e drejta e ankimit, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, duhet kup-

pa pasur një zgjidhje për çështjen. Me synim zgjidhjen e problematikave, janë hartuar strategji duke u bazuar në aktet ndërkombëtare (KEDNJ) dhe modelet e vendeve më të zhvilluara, që e ndjekin praktikën e gjykimit në dy shkallë. Pënisur nga modeli i gjykimit që është ndjekur dhe vazhdon ende të

“ Rregullimi ligjor shqiptar i ofron mundësi individit për të pasur akses në të tria shkallët e gjykimit, një model që në teori është i përshtatshëm, por në praktikë ka shfaqur problematikat e tij, sidomos në gjykimin e çështjeve civile. Shpesh në praktikë gjykimi në tri shkallë e zvarrit procesin, palët marrin një zgjidhje arbitrare nga gjykata ose mbeten në situata konfliktuale, pa pasur një zgjidhje për çështjen. ”

tuar si mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Sipas Kushtetutës, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është një tejkallim pozitiv krahasuar me standardet e Europiane të Drejtave të Njeriut¹⁰.

Rregullimi ligjor shqiptar i ofron mundësi individit për të pasur akses në të tria shkallët e gjykimit, një model që në teori është i përshtatshëm, por në praktikë ka shfaqur problematikat e tij, sidomos në gjykimin e çështjeve civile. Shpesh në praktikë gjykimi në tri shkallë e zvarrit procesin, palët marrin një zgjidhje arbitrare nga gjykata ose mbeten në situata konfliktuale,

ndiqet, parashikimi që Gjykata e Lartë të rishikojë vendimet e gjykatave më të ulëta vetëm për shkaqe të rëndësishme të ligjit, deri diku e kufizon të drejtën për të pasur akses në gjykatë. Nga ana tjetër, një masë e tillë rrit përgjegjësinë e gjykatës së shkallës së parë dhe Gjykatës së Apelit për një angazhim serioz, pa zvarritje të proceseve dhe në mbështetje të parimeve për një proces të rregullt ligjor.

Parë në këndvështrimin e parimit të aksesit në gjykatë, me rëndësi është gjithashtu edhe çështja e tarifave gjyqësore. Në raportet e ekspertëve të fushës ekonomike dhe juridike rezultoi se aktualisht gjendemi në një situatë të paqartë ligjore në përcaktimin e tarifave gjyqësore. Mungesa e hierarkisë së tarifave të pagesave të lidhura me shkallët gjyqësore, mungesa e një difference mes çështjeve të zakonshme dhe çështjeve tregtare,

mungesa e plotë e aplikimit të tarifave në Gjykatën Kushtetuese, edhe në vitet e fundit është shtuar vullneti i punës së saj, kanë sjellë nevojën për të ndërmarrë masa konkrete¹¹.

Sot gjendemi përpara një sistemi të ri tarifimi për çdo shërbim juridik në gjykatë. Vlen të theksohet se problematikat nuk duhet analizohen vetëm në këndvështrimin e gjykatës, sepse së pari ato prekin individin e thjeshtë që i drejtohet gjykatës. Riorganizimi i tarifave duhet të jetë proporcional dhe i bazuar në kushtet ekonomike të vendit e mbi të gjitha mbi mundësitë reale të qytetarëve për të pasur akses në gjykatë. Pamundësia ekonomike nuk duhet të jetë shkak për të limituar ose kufizuar të drejtën për të pasur akses në gjykatë. Në çështjen "Airey kundër Irlandës" Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi se refuzimi për dhënien e ndihmës juridike një gruajë të varfër që kërkonte zgjidhjen e martesës për shkak se bashkëshorti i saj ishte abuziv, përbën shkelje të së drejtës për akses në gjykatë sipas nenit 6 (1).

Përfundime

Në kuadër të një procesi të rregullt ligjor gjithkujt duhet t'i sigurohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, si dhe t'i sigurohen mjetet juridike efektive për të kërkuar mbrojtjen e një të drejte civile të shkelur apo për kundërshtimin e një akuze penale. Kusht për një proces të rregullt ligjor përbën aksesin efektiv në gjykatë, i konsideruar si hallka e parë lidhëse mes individit dhe gjykatës.

Mjaft raste nga praktika gjyqësore shqiptare, por edhe europiane, kanë treguar se mungesa e një kornize ligjore të plotë, paqartësia rreth përcaktimit të kompetencave të gjykatave, zvarritja e proceseve dhe mosrespektimi i afateve ligjore, kryesisht në çështjet civile, sistemi i tarifave gjyqësore joproporcionale e mbi të gjitha mungesa e përdorimit të mekanizmave të nevojshëm nga shteti janë faktorë që e cenojnë parimin e aksesit në gjykatë.

Analiza e problematikave, hartimi i një strategjie riorganizimi dhe krijimi i një kuadri të ri ligjor janë tregues të ndërmarrjes së hapave konkretë drejt krijimit të shtetit të së drejtës. Për këtë arsye vlen të theksohet se reforma në drejtësi është një mekanizëm i domosdoshëm lidhur me nevojën për të arritur objektiva e

i Gjykatës Kushtetuese

7. "E drejta civile", Julana Latifi

8. Relacioni për projektligjin "Për tarifat dhe shpenzimet gjyqësore në Republikën e Shqipërisë", nga Ulsi Manja.

9. Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"

Në kuadër të një procesi të rregullt ligjor gjithkujt duhet t'i sigurohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, si dhe t'i sigurohen mjetet juridike efektive për të kërkuar mbrojtjen e një të drejte civile të shkelur apo për kundërshtimin e një akuze penale. Kusht për një proces të rregullt ligjor përbën aksesin efektiv në gjykatë, i konsideruar si hallka e parë lidhëse mes individit dhe gjykatës.

përjasje të sistemit ligjor shqiptar me modele të vendeve europiane. Vendi ynë është ende në fazat fillestare të zbatimit të reformës, për të cilën kërkohet kohë dhe angazhim nga çdo pjesë e sistemit të drejtësisë, por për arritjen e rezultateve konkrete dhe për gjykata më efektive e të aksesueshme duhet një punë serioze, me frymën e respektit për të drejtat dhe liritë themelore të individit.

Literatura:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Konvena Europiane e të Drejtave të Njeriut.
3. "Analiza e sistemit të drejtësisë në Shqipëri", Tiranë, 2015.
4. "Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë" dhe "Plani i veprimt".
5. Vendim nr. 8, datë 26.02.2015 i Gjykatës Kushtetuese.
6. Vendim nr. 42, datë 29.09.2011

10. <http://shqiptarja.com/home/1/zvarritja-e-gjyqeve-nd-shkim-kush-shtyn-seancat-afatet-e-reja-393390.html>

11. <http://www.humanrights.is/en/human-rights-education-project/comparative-analysis-of-selected-case-law-achpr-iachr-echr-hrc/the-rights-to-due-process/the-right-to-access-to-court>

12. <http://www.reformanedrejttesi.al/pse-nje-reforme-ne-drejttesi>

⁸. Për çështjet civile dhe administrative kërkesa për rishikim paraqitet në Gjykatën e Lartë. Për çështjet penale kërkesa për rishikim paraqitet në gjykatën e rrethit që ka dhënë vendimin.

⁹. <http://shqiptarja.com/home/1/zvarritja-e-gjyqeve-nd-shkim-kush-shtyn-seancat-afatet-e-reja-393390.html>

¹⁰. Vendimi nr. 42, datë 29.09.2011 i Gjykatës Kushtetuese.

¹¹. Bazuar në relacionin për projektligjin "Për tarifat dhe shpenzimet gjyqësore në Republikën e Shqipërisë", nga Ulsi Manja.